



Nr. 674 Prot, datë 03.09.2021

Nr. Extra Prot, datë 03.09.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT “Barleti”

DHE

GENIUSLAB

TIRANË

Universiteti “Barleti” i përfaqësuar nga Prof. Dr. Suzana Guxholli dhe GeniusLab, i përfaqësuar nga Z. Valbona Cullhaj, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institacioneve do të përfshijë:

- a. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
- b. Shkëmbimin e ambienteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mqedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institacioneve.
- c. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimitarive të tjera shkencore (konferanca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);

d. Punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

Neni 2

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potentialit të disponueshme nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-d) dhe ndjekja e zbatimit të marrëveshjes, do të realizohet nga i ngarkuari përfaqësues nga secili institucion.

Neni 3

Çdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institacioneve.

Neni 4

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinosohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej institacioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.


Kjo marrëveshje hartohet në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, tekstet e saj janë autentike.

Tiranë, më datë ___/___/2021

REKTORI

I UNIVERSITETIT “BARLETI”

PROF. DR SUZANA GUXHOLLI



ADMINISTRATORI

GeniusLab

VALBONA CULLHAJ

